

R A P O R T

(mbi zhvillimin e workshop-it mbi sigurinë ushqimore)

Në datat 3 dhe 4 Dhjetor 2013, në Hotel “Rogner” Tiranë, u mbajt “Workshopi kombëtar, ndërinstitutional mbi sigurinë ushqimore” me pjesëmarrjen e gjerë të specialistëve të ISHP-së dhe DSHP-ve të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Lushnjës dhe Gjirokastrës, si dhe specialistëve të ISUV.

Ky workshop u organizua nga ISHP dhe ISUV dhe u mbështet nga zyra e OBSH-së në Tiranë. Në këtë event morrën pjesë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, zv/ministre Milva Ekonomi, menaxhere e programeve të sigurisë ushqimore në Zyrën Rajonale të OBSH-së për Evropën PhD Hilde Kruse, drejtori i zyrës së OBSH-së në Tiranë Dr. Vasil Miho, përfaqësues nga EFSA znj. Anca Stoicescu, përfaqësues nga ISS i Romës z. Paolo Pasquale, si dhe drejtori i ISUV z. Vitor Malutaj.

Qëllimi i workshop-it ishte realizimi i një bashkëpunimi ndërsektorial dhe ndërinstitutional në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për arritjen e objektivit madhor “Një Shëndet”, për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.

Siguria ushqimore është një disiplinë shkencore që përshkruan trajtimin, përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimit, në mënyrë që të parandalojë sëmundjet me origjinë ushqimore. Gjithë rrugëtimi i përgatitjes së ushqimit, nga lënda e parë (e papërpunuar) deri në produktin gati për konsum, vendos një lidhje detyruese midis institucioneve të industrisë, tregut dhe konsumatorit.

Sëmundjet me origjinë ushqimore janë indikator kryesor që përcakton qartë funksionimin e sistemit të sigurisë ushqimore të çdo vendi. Patogjenet zoonotike janë shkaktarë të një përqindjeje të madhe të sëmundjeve njerëzore; rreth 60% e sëmundjeve njerëzore janë të shkaktuara nga patogjenet zoonotike.

Survejanca e sëmundjeve me origjinë ushqimore është një domosdoshmëri për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të shëndetit publik.

Në vendin tonë, për vitin 2012 rastet me gastroenterite të paspecifikuara ishin 56495 ose 94 % e sëmundjeve diarreike, nga të cilat 6% e zënë sëmundjet me origjinë ushqimore, incidenca e të cilave arrin vlerën 108.2/100.000 banorë.

Çdo vit, vetëm në Komunitetin Evropian, mbi 25 000 njerëz vdesin nga infeksione të shkaktuara nga baktere rezistente ndaj antibiotikëve. Antibiotiko – rezistenca është gjithashtu një problem i sigurisë ushqimore: antibiotikët e përdorur në ushqimet e kafshëve për trajtimin, parandalimin e sëmundjeve ose promovimin e rritjes së tyre, krijojnë rezistencën bakterore edhe tek njerëzit.

Workshop-i u fokusua në disa drejtime kryesore si:

1. Nxjerrjen e problematikës lidhur me sëmundshmërinë me origjinë ushqimore dhe zoonotike në Shqipëri dhe Evropë, si dhe problematikën e Antibiotiko – Rezistencës (AMR) nga një këndvështrim i sigurisë ushqimore.

2. Parashtrimin e shumë fakteve dhe argumenteve të rëndësishme për vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, kombëtar, ndërinstitutional dhe ndërsektorial me qëllim qasjen “Një Shëndet”
3. Diskutime ndërinstitutionale në grupe pune për mënyrën e vendosjes së bashkëpunimit dhe krijimit të sistemit tëurvejancës për AMR.

Siguria e ushqimeve është një problematikë shumë dimensionale e cila kërkon harmonizim e bashkëpunim ndërinstitutional dhe ndërsektorial, shkëmbim informacioni, kapacitete njerëzore, laboratorë të çertifikuar dhe/ose të akredituar.

Në përfundim të workshop-it rezultoi se:

- Pjesëmarrësit treguan interesim të madh lidhur me workshopin që u shpreh në diskutimet e shumta, përfshirjen aktive në grupet e punës dhe praninë kostante të tyre në të gjitha sesionet e aktivitetit.
- Aktiviteti mundësoi paraqitjen e ecures së sëmundjeve zoonotike me origjinë ushqimore në shërbimin shëndetësor, analizoi faktorët e riskut ndaj zoonozave në gjithë zinxhirin ushqimor, në fermë dhe imputet e saj, transportin e kafshëve dhe produktet e tyre, operatorët e biznesit, tregun, kuzhinën dhe komunitetet.
- U diskutua gjerësisht mbi sistemin e shërbimit veterinar dhe atij shëndetësor, mbi institucionet e inspektimit të zinxhirit ushqimor/zoonozat, mbi mekanizmat e bashkëpunimit midis aktorëve përgjegjës, si dhe kapaciteteve të tyre.
- U bë analizimi i faktorëve të riskut ndaj zoonozave të lidhura me zinxhirin ushqimor dhe u vlerësua në kuadër të konceptit “Një Shëndet”. Kjo mundësoi analizimin e faktorëve të riskut në ndërlidhjen e shëndetit të kafshëve me atë të njeriut dhe ekosistemit/mjedisit ku ata jetojnë.
- U analizuan të gjitha pikat e dobëta të bashkëpunimit midis shërbimit shëndetësor, shërbimit veterinar dhe institucioneve të inspektimit. Mbështetur në to u sugjeruan elementët e bashkëpunimit në nivel qendror dhe lokal.

Në nivel lokal u vlerësua i domosdoshëm bashkëpunimi në nivel të institucioneve të mëposhtme:

- Mjekut të familjes dhe veterinerit zyrtar dhe atij privat.
- Drejtorive të Shëndetit Publik dhe Drejtorive Rajonale të Bujqësisë në shkëmbimin e informacionit, ndjekjen e përbashkët të rasteve epidemike, vlerësimin e faktorëve të rrezikut, raportimin, përgatitjen e planeve të

përbashkëta të minimizimit dhe parandalimit të zoonozave të lidhura me zinxhirin ushqimor.

- Laboratorëve rajonal të shëndetit publik dhe laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe të shëndetit të kafshëve.

Në nivel qendror u vlerësua e domosdoshme:

- Ngritja e një grupi pune ndërsektorial dhe multidisiplinor për të planifikuar, bashkërenduar dhe ndjekur problematikat e zoonozave dhe antibiotiko-rezistencën të lidhura me zinxhirin ushqimor.
- Ngritja e sistemit të survejancës për sëmundjet me origjinë ushqimore.
- Forcimi i rrjetit të laboratorëve të kontrollit dhe të referencës.
- Shkëmbimi periodik i informacionit midis ISUV dhe ISHP-së për zoonozat dhe antibiotiko-rezistencën, duke pasur si objektiv vlerësimin e peshës së sëmundjeve zoonotike në të dy sistemet, modelin epidemiologjik të tyre, shtrirjen gjeografike dhe mbështetur në to, vlerësimin e faktorëve të riskut dhe përgatitjen e strategjive parandaluese.
- Ngritja e një komiteti ndërsektorial për të ndjekur problematikat e antibiotiko-rezistencës së patogjeneve në zinxhirin ushqimor në Shqipëri. Kjo u konsiderua thelbësore, krahas ngritjes së sistemit të survejancës me përfshirjen e të dy sektorëve dhe zhvillimit të një strategjie kombëtare për të mundësuar mirëpërdorimin dhe minimizimin e përdorimit të antibiotikëve.